



[Per diskutim](#)
[publikuarë in](#)

Administrimi i Burimeve Ujore ne Evropen Juglindore

Volumi II

*Informacion per
Shqiperine*

SHQIPËRIA

Konteksti ekonomiko-shoqëror dhe gjeografik

Shqipëria ndodhet në perëndim të gadishullit të Ballkanit. Shqipëria është shteti më i vogël i Evropës, me një sipërfaqe 2.9 milionë hektarë (ha). Shqipëria është një vend kodrinoro-malor dhe përbëhet nga dy rajone gjeografike të ndara qartë: rajoni malor mbi 300 metra (m), që përbën afërsisht tre të katërtat e territorit; dhe zonat fushore ose kordinore të ulta, që përfshijnë zonën bregdetare të detit Adriatik dhe Jon (476 km). Klima varion nga topografia: verë të nxehta dhe të thata dhe me stuhi me bubullima dhe nga dimra të lagët dhe të butë në zonat fushore; ndërsa zonat malore karakterizohen nga precipitimi dhe dimra më të fohhtë dhe shumë më të fortë me dëborë në male. Precipitimi mesatar është 1,485 milimetra (mm). Në bregdet reshjet vjetore arrijnë në 1,000 mm, ndërsa në male arrijnë në 3,000 mm. Shumica e precipitimit kalon në lumenj dhe rrjedh në detin Adriatik. Gjithashtu, përmes Shqipërisë kalon edhe një sasi e madhe ujrash nga vendet fqinje.

Popullsia e vendit në vitin 2000 ishte 3.13 milionë banorë dhe më shumë se gjysma e popullësisë (58%) jeton në zonat rurale. Burimet ujore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit: afërsisht 97% e gjithë prodhimit energjitik sigurohet nga hidrocentralet, kryesisht nga lumenjtë e Drinit, Matit dhe Bistricës; dhe rreth 50% e tokës bujqësore ujitet duke prodhuar afërsisht 80% të prodhimit bujqësor.

Baza e Burimeve Ujore

Për qëllimet e administrimit të ujrave, Shqipëria ndahet në gjashtë basene kryesore hidrografike. Një e treta e tyre gjendet jashtë Shqipërisë. Afërsisht 50% e territorit gjendet në basene ndërkombëtare që janë të përbashkëta me Greqinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë dhe Malin e Zi.

Burime të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Shqipëria mund të konsiderohet një vend me shume burime ujore. Burimet e saj të përgjithshme të rinovueshme arrijnë në 41.7 miliardë metra kub (BCM) ose 13,300 metra kub (m³) për frymë, nga të cilat rreth 65% sigurohen brenda vendit dhe pjesa tjetër nga

vendet fqinje (d.m.th, Serbia dhe Mali i Zi dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Burimet ujore në vend nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin. Burimi kryesor ujqor është uji i sipërfaqeve dhe gjendet në lumenj, liqene dhe laguna. Lumenjtë më të rëndësishëm janë: Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani, Vjosa dhe Bistrica. Drini është lumi më i gjatë që ka edhe një rrjedhje të qendrueshme. Afërsisht një e treta e zonës së tij të rrjedhjes është brenda Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër brenda pjesës së Adriatikut të ujëmbledhësit të Kosovës dhe zonave të liqeneve të Skadarit, Prespës dhe Ohrit.

Për shkak të topografisë malore, lumenjtë rrjedhin përmes kodra të pjerrta. Ndryshueshmëria e tyre vit pas viti është shumë e lartë: rrjedhjet vjetore në vite të thata përbëjnë një të dhjetën e rrjedhjeve vjetore në vite të lagësht. Shumica e lumenjve paraqesin modele shumë të çrregullta të rrjedhjes sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës. Pothuajse të gjithë kanë më pak se 10% (dhe nganjëherë zero përqind) të mesatares së tyre të dimrit në stinën e verës. Lumenjtë janë të vështirë për t'u kontrolluar dhe janë të palundrueshëm, me përjashtim të lumit të Bunës. Shqipëria është e prirur ndaj erozionit të tokës. Megjithëse, ky është një fenomen natyror në vende malore me rreshje të shumta, në rastin e Shqipërisë kjo është thelluar edhe më nga aktivitetet e dorës së njeriut (p.sh shpyllëzimi) dhe ka rezultuar në sasi të mëdha sedimentesh nëpër rezervuarë, lumenj dhe dete.

Liqenet zënë 4% të territorit të vendit. Liqenet më të mëdha janë ato të Ohrit, Prespës dhe Skadarit. Këto janë liqene ndërkuftare. Përveç këtyre ka edhe 247 liqene më të vogla. Aktualisht, liqenet janë në fazë oligotrofike, me përjashtim të disa zonave ku shkarkimet në lumenjtë tributorë kanë rritur përqëndrimin e nitrogjenit dhe fosforit. Përgjatë lumenjve të Drinit, Matit dhe Devollit janë ndërtuar disa rezervuarë me një total 5.60 BCM kapacitet mbajtës për mbrojtje nga përmytjet, për qëllime ujitjeje dhe për prodhim të energjisë elektrike.

Burimet nëntokësore janë gjithashtu abondante dhe përfaqësojnë rreth 23% të totalit të burimeve të rinovueshme¹. Këto burime janë të shpërndara mirë në të gjithë vendin dhe shfrytëzohen nga pusët (në lugina dhe fusha) dhe burime (në rajonet malore). Megjithatë, burimet rrezikojnë të thahen gjatë stinës së verës (Baseni i shtresës ujëmbajtëse në Mat). Burimet nëntokësore janë burimi kryesor i ujit të pijshëm. Afërsisht 70% e qyteteve kryesore të vendit furnizohen me ujë nga pusët nëntokësore. Gjithashtu, ato janë edhe burimi kryesor për ujitje dhe për bujqësinë në zonat e Shkodrës dhe Vlorës.

Zonat e lagta. Shumica e lumenjve të Shqipërisë formojnë në gojë të tyre një sërë lagunash, kënetash dhe zona të lagta. Gjatë rregjimit të mëparshëm, zonat e mëdha të lagta përgjatë bregdetit u thanë dhe u kthyen në toka bujqësore. Rrjedhimisht, u zhdukën disa nga zonat e vlefshme të lagta. Disa nga lagunat e mëdha përgjatë vijës bregtare janë: laguna e Karavastasë, Nartës dhe Butrintit, të cilat përfaqësojnë zonat e lagta me rëndësi të madhe globale për biodiversitetin. Disa nga këto laguna janë pjesë e konventës Ramsar. Këto ekosisteme natyrore ujore tepër të rëndësishme për vlerat e tyre të mëdha për biodiversitetin po kërcënohen nga ngarkesa të ndotjes dhe në shumë raste po përdoren për shkarkimin e ujrave të zeza të patajtura.

Cilësia e Ujit. Qysh nga viti 1990, monitorimi i ujit ka qenë shumë më pak frekuent. Rrjedhimisht, cilësia e burimeve ujore nuk njihet mirë. Sipas informacionit të disponueshëm, ujrat e sipërfaqes janë shumë të ndotur si rezultat i hedhjes/derdhjes së mbeturinave urbane dhe ujrave të ndotura industriale në trupa ujore sipërfaqësore. Cilësia e disa lumenjve është mbi maksimumin e standardeve të Bashkimit Evropian për cilësinë e ujit të lumenjve. Shumë nga lumenjtë e rëndësishëm kanë treguar shenja ndotjesh të mëdha nga lëndë organike—ato kanë deficite në oksigjen të tretur me nevoja të larta kimike për oksigjen (COD) dhe oksigjen biologjik (BOD).

Në përgjithësi, burimet nëntokësore janë të një cilësie të mirë në burim. Megjithatë, cilësia e tij nuk monitorohet në vazhdimësi në të gjithë vendin. Ka disa lokalitete ku kjo njihet fare pak. Megjithatë,

¹ At present, not much is known about the availability of [groundwater](#)^{nëntokësore} or the potential extraction capacity. [Groundwater](#)^{Nëntokësore} monitoring and assessment has been neglected during the past decade.

kjo rezervë strategjike ujore aktualisht po has disa probleme serioze në lidhje me cilësinë e ujit: futja e ujrave të kripur në shtresën ujëmbajtëse (në rajonet bregdetare të Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Lushnjës dhe Fierit), degradimi i cilësisë së ujit si pasojë e neglizhimit të zonave sanitare mbrojtëse përfaqëse të ujit (shtresa ujëmbajtëse e Ishmit që ushqen Tiranën) dhe ndjeshmëria ndaj ndotjeve të rrjedhës së sipërme, sidomos në zonat karstike, ku shkarkimet e patrajuara filtrojnë shpejt në tokë dhe arrijnë në shtresën e poshtme (shtresa ujëmbajtëse e Shkodrës).

Përdorimi i ujit dhe administrimi i tij sipas sektorëve

mungesa e një sistemi adekuat për monitorimin, ndryshimet e shpejta të aktiviteteve ekonomike dhe lëvizjet e shpeshta të popullsisë e bëjnë të vështirë vlerësimin e burimeve ujore. Të dhënat e disponueshme sugjerojnë se ujitja dhe minierat mbështeten kryesisht në ujin e sipërfaqes, ndërsa familjarët dhe industria tek burimet nëntokësore nga shtresat ujëmbajtëse. Sipas projekt- strategjisë për Ujin në vitin 1995 përdorimi total i ujit ishte 0.93 BCM, ku uji për industrinë dhe familjarët përgjigjej për 28% dhe uji për ujitje ishte 72%. Megjithëse, uji duket të jetë i bollshëm për të plotësuar kërkesat aktuale dhe të ardhshme, në Shqipëri ka disa rajone—sidomos në zonat përgjatë bregdetit – ku në një të ardhme të afërt ka gjasa të ketë konflikte për ujin p.sh., në Durrës-Vlorë, konflikte në lidhje me përdorimin e ujit do të linin edhe midis furnizimit bashkiak, ujitjes dhe turizmit.

Uji i pijshëm dhe higjiena. Megjithëse sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm mbulon të gjithë vendin dhe niveli i mbulimit arrin në 85%, furnizimi me ujë është me hope për shkak të kushteve jashtëzakonisht të këqia të infrastrukturës ujore të Shqipërisë. Në rastin e zonave urbane, furnizimi me ujë sigurohet mesatarisht 2-4 orë në ditë, ndërsa ka edhe shumë familje që nuk furnizohen fare me ujë. Përveç kësaj, shpesh edhe cilësia e ujit të pijshëm nuk është e mirë. Shpesh, uji shpërndahet pa asnjë lloj trajtimi paraprak si rezultat i mungesës së impjanteve të përshtatshme për trajtimin e ujit dhe disinfektimin e tij, si edhe për shkak të ndërprerjeve dhe mos furnizimit të rregullt me kimikate. Kërkesa vendase për ujë ka ardhur duke u rritur jo vetëm si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë, por edhe për shkak të rritjes së

nivelit të humbjeve në ujë që llogariten mesatarisht të jenë mbi 50% në të gjitha qytetet.

Gjendja e ujit në zonat rurale është edhe më e vështirë. Në lokalitetet që kanë rrjete të furnizimit me ujë përmes ujësjellsave, uji i pijshëm supozohet të furnizohet përmes çezmave publike në grupe shtëpish, por kjo nuk po ndodh për shkak se sistemet nuk mirëmbahen siç duhet. Në fund të vitit 1989, afërsisht 75% e popullësisë rurale kishte akses në ujë nga ujësjellsat. Sot, ky akses është ulur në 50%. Me qëllim përballimin e mungesës së furnizimit me ujë nga ujësjellsat, familjet në zonat rurale hapin vetë puse pa asnjë lloj monitorimi të cilësisë së ujit. Në disa raste, puset hapen në brigje lumenjsh shumë të ndotur, ujrato e të cilëve nuk janë të përshtatshëm për konsum nga njeriu. Mungesa e zonave të mbrojtjes sanitare po shkakton ndotjen e burimeve nëntokësore. Sipas një hulumtimi të kohëve të fundit, 73% e puseve që përdoren për ujë të pijshëm janë të ndotur bakteriologjikisht.

Gjatë dekadave të fundit, investimet për trajtimin/pastrimin e ujërave të zeza dhe kanalizimeve të tyre kanë qenë të pamjaftueshme për t'i bërë ballë rritjes së numrit të popullësisë. Rrjedhimisht, shumica e familjeve në zonat urbane i derdh ujrato e zeza direkt në sistemet qendrore të ujërave të zeza, që mbulojnë afërsisht 40% të popullësisë. Lagjiet më të varfra që nuk kanë fare akses në sistemet e ujërave të zeza i derdhen ujrato e zeza në gropat septike. Në Shqipëri nuk ekzistojnë impjante për trajtimin e ujërave të zeza. Ujrato e zeza të patrajtuara derdhen në mënyrë të pakontrolluar. Në zonat rurale, familjarët përdorin në oborrët e tyre gropat septike. Rrjedhjet nga gropat septike po bëhen gjithashtu problematike.

Ujitja dhe kullimi. Duke qenë se më pak se 21% e precipitimit vjetor ndodh gjatë muajve prill dhe shtator, ujitja nevojitet për bujqësinë në zonat e thata fushore. Aktualisht, bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në Shqipëri (duke përfaqësuar 55% të GDP) dhe përdoruesi kryesor i ujit. Afërsisht 50% e tokës së punueshme është e mbuluar me ujitje dhe më shumë se gjysma gjendet në fushat përgjatë bregdetit.

Ujitja bazohet kryesisht tek ujrato sipërfaqësore—shmangie të lumenjve të ndjekur nga 600 diga ujitjeje. Megjithatë uji është i

një cilësie të kënaqshme për ujitje, elementët e minierave dhe ato industriale po ndosin ujrat sipërfaqësore duke i bërë të papërshtatshëm për ujitje. Kullimet jashtë sezonit nevojiten për të penguar përmytjet dhe prurjet e drurëve.

Investimet masive të viteve 1950-1975, çuan në zgjerimin e tokës së ujitur nga 29,000 ha në 417,000 ha. Zhvillimi i ujitjes u shoqërua nga punimet për mbrojtjen nga përmytjet, kullimet dhe tharja e kënetave poshtë nivelit të detit dhe zonave të kripura (afërsisht 280,000 ha). Skemat e kullimit në Shqipëri janë përqëndruar kryesisht në zonat bregdetare. Shumica e zonave të lagta në fushat përgjatë bregdetit (rreth 100,000 ha) u drenazhuan për të lejuar zhvillimin e zonave bujqësore. Sot, kanë mbetur vetëm 27,000 ha zona të lagta.

Sistemet e ujitjes u përkeqësuan gjatë viteve 90-të. Buxheti i pamjaftueshëm për skemat ujitëse ka çuar në mirëmbajtje të vonuar ose të dobët dhe në degradim të sistemit. Në vitin 1994, 269,000 ha tokë ishin shumë të dëmtuara dhe vetëm 80,000 ha operonin në mënyrë normale. ndërkaq po hartohen plane për rehabilitimin e skemave të ujitjes. Sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, janë afërsisht 315,000 ha tokë që potencialisht mund të rehabilitohen. Gjithashtu, sipas të njëjtit burim, 100,000 ha që mbeten nuk duhet të rehabilitohen për shkak të potencialit të tyre të ulët bujqësor.

Rehabilitimi i skemave të ujitjes duhet të shoqërohet nga një sërë masash për administrimin e ujëmbledhësive me qëllim parandalimin ose uljen e erozionit të tokës dhe rrjedhje të shpejtë në zonat e sipërme. Aktualisht, këto përbëjnë probleme serioze për skemat e ujitjes. As fermerët dhe as qeveria nuk mundën ta përballojnë koston e heqjes së materialeve të erodura nga kanalet, rezervuarët dhe kanalet e drenazhimit. Në investimin në sektorin e ujitjes duhet të ndiqet një përjasje më e qëndrueshme për administrimin e ujëmbledhësive.

Fermerët kanë filluar zhvillimet nëntokësore private—puse të cekta mesatare. Afërsisht 1,000 ha ujitën me burime nëntokësore, por duket se midis fermerëve ka nisur një tendencë për rritjen e kësaj zone dhe motivet janë disa: çmimi i lartë i zarzavateve dhe mungesa e rehabilitimit të **gravity channels**. Ky është një variant i përshtatshëm për fermerët e vegjël privatë që ndodhen në skemat ekzistuese të ujitjes, në toka pa ujitje ose në toka që kanë

nevojë për drenazhim, me kusht që **tubewells** të mos kërcënojnë cilësinë e shtresës ujëmbajtëse me kripra.

Në rast se problemet e mjedisit nuk merren parasysh gjatë rimëkëmbjes së sektorit të bujqësisë në vend, zonat e lagta përgjatë bregdetit mund të kërcënohen nga investimet në sektor, si rezultat i shtimit të ngarkesave të ndotjes të ujit të kullimit. Përveç kanosjes që i shkakton lagunave bregdetare eutrofikimi, uji i kullimit mund të ketë ndikim negativ në burimet e ujit të pijshëm.

Hidroenergjitike: Potenciali bruto teorik i energjisë elektrike llogaritet afërsisht në 40,000 gigavat orë në vit (GWh/vit) dhe potenciali i mundshëm teknik në 5,000 GWh/vit. Nga ana tjetër, potenciali i mundshëm ekonomik është llogaritur në 6,380 GWh/vit nga të cilat afërsisht 35% gjenerohen deri tani mbi lumin Drin. Në vitin 2000, prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ujore përfaqësonte afërsisht 83% të prodhimit total elektrik në vend. Aktualisht po hartohen plane për zhvillimin e potencialit energjistik me baz hidro në lumenjtë e Vjosës dhe Devollit. Startegjia për sektorin e energjisë kërkon zhvillimin e kapaciteteve të reja hidro.

Përmytjet. Përmytjet janë një problem i vazhdueshëm në Shqipëri, sidomos në periudhën nga nëntori në mars, kur edhe probabiliteti për rreshje të mëdha ose të zgjatura është edhe më i madh. Zona që ka më shumë gjasa të përmytet është fusha perendimore ku lumenjtë nga zonat malore të Shqipërisë rrjedhin në detin Adriatik. Fusha perendimore është edhe qendra e popullësisë së Shqipërisë: mbi 50% e popullësisë shqiptare banon në këtë zonë dhe tendenca është që kjo përqindje të rritet. Fusha e Drinit në veri dhe ajo e Vjosës në jug janë në veçanti të prirura ndaj përmytjes. Piku i rritur i shkarkimeve dhe përmytjet janë rrjedhojë e shpyllëzimeve masive.

Kostoja vjetore e përmytjeve nuk dihet; qysh nga viti 1949 nuk është bërë asnjë monitorim i rregullt i përmytjeve dhe rregjistrimi që filloi që atëherë nuk i publikoi të dhënat e plota. Përmytjet më të mëdha me dëme katastrofike i përkasin periudhës gjatë viteve 1962-63. Përmytjet u konsideruan si ngjarje që ndodhin një herë në pesëdhjetë vjet.

Ka edhe përmbytje në shkallë të vogël. Përmbytjet në nëntor të vitit 1992 shkaktuan përmbytje në gjashtë rrethe. Si pasojë humbën jetën njëmbëdhjetë persona, u dëmtuan rrugë, ura dhe rrjete ujitjeje, si edhe u përmbytën 17,000 tokë bujqësore, u shkatërruan 1330 shtëpi dhe u dëmtuan 216 të tjera, u dëmtua impjanti hidroenergjitik i Fierzës. E gjitha në total ndikoi në jetën e 35,000 njerëzve. Përmbytjet e shtatorit të vitit 1995 shkaktuan katër viktima dhe ndikuan në jetën e 1500 të tjerëve.

Fusha e Zadrimës përmbytet disa herë në vit për shkak të dëmtimit të sistemit të kullimit gjatë periudhës së tranzicionit. Kanali kryesor i kullimit të zonës nuk mirëmbahet dhe rrjedhimisht ndodhin përmbytje duke shkaktuar probleme serioze në veçanti në sektorin e bujqësisë. Lezha u përmbyt në dhjetor të vitit 1995, në shtator 1996 dhe prapë në dhjetor 1997. herën e fundit, dëmi arriti në afërsisht USD120,000.

Aktivitetet për kontrollin e përmbytjeve janë neglizhuar për mungesë fondesh. Qysh nga qershori i vitit 2000, instituti që më parë merrej me hartimin e sistemeve për mbrojtjen nga përmbytjet u mbyll. Drejtorja e Përdorimit të Ujrave që përgjigjet për mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet nuk ka fonde. Shoqatave të Përdoruesëve të Ujit të caktuara për të marrë përsipër funksionet e Drejtorisë iu ngarkua mirëmbajtja e sistemit të ujitjes, por jo kontrolli i përmbytjeve, që duket se ka mbetur jetim në sistemin e ri. Një departament i ri i sapo krijuar i Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Pushtetit Lokal ende nuk ka ekspertë teknikë.

Përveç punimeve për mbrojtjen nga përmbytjet, zbatimi i rregullavce për veprimtaritë nxjerrëse mund të kontribuojnë ndjeshëm në reduktimin e ndjeshëm të dëmtimeve të shkaktuara nga përmbytjet. Aktualisht, shtëpitë ndërtohen me zhavor dhe rërë që nxirret në mënyrë të paligjshme nga brigjet e lumenjve dhe bregdeti në zonat përreth. Kjo praktikë e paligjshme ka çuar në modifikime të rrjedhës së lumit.

Legjislacioni dhe politikat për uj

Legjislacioni kryesor për administrimin e burimeve ujore është ligji i vitit 1996 për burimet ujore, që përcaktonte Këshillin Kombëtar të Ujit dhe Sekretariatit të tij Teknik. Ky ligj bazohet

në parimet moderne të administrimit të ujit. Shkurt, ligji parashikon mbrojtjen, zhvillimin, dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore; organizon administrimin e burimeve ujore përmes basenit të lumit; parashikon lejet, koncensionet dhe autorizimet për përdorimin e ujit dhe për shkarkimin e ujrave të zeza; dhe kërkon zhvillimin e një strategjie për ujin.

Kohët e fundit është hartuar një Ligj për Mbrojtjen e Ujit, i cili aktualisht po rishikohet. Ligji trajton ekskluzivisht zbatimin e legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e cilësisë së trupave të ujit me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Nga ana institucionale, projekt-ligji sqaron rolin e Këshillit Kombëtar të Ujit dhe i jep më shumë përgjegjësi Ministrisë së Mjedisit për mbrojtjen e burimeve ujore.

Në vitin 1997 u hartua një “Strategji Kombëtare për Ujin në Shqipëri”, ndihmesën e Bashkimit Evropian. Projekt-strategjia stimulon “konservimin e burimeve ujore dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në harmoni me mjedisin dhe burimet e tjera natyrore.” Strategjia evidenton qartë objektivat kombëtare për përdorimin dhe administrimin e ujit dhe sugjeron ndryshime në kuadrin institucional për zbatimin e strategjisë. Strategjia përcakton prioritetet institucionale radikale me qëllim vendosjen e linjave të qarta të vendimeve të politikave brenda kuadrit institucional, duke përfshirë edhe Këshillin Kombëtar të Ujit dhe ministrinë përkatëse të linjës, në veçanti ato që përgjigjen për mbrojtjen e mjedisit, ujitjen dhe furnizimin me ujë të pijshëm. Në fazën e saj përfundimtare, strategjia hasi në kundërshtime dhe rrjedhimisht nuk u zbatua asnjëherë.

një ligj i ri u adoptua në vitin 2002 mbi Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal. Ky ligj ua kalon përgjegjësinë e plotë për administrimin, shërbimin, investimet dhe rregullimin e furnizimit me ujë, sistemet e ujrave të zeza dhe kullimit, si edhe kanalet për mbrojtjen nga përmbytjet pushteteve lokale. Për zbatimin e këtij ligji, ka nevojë të përmirësohet kapaciteti i bashkive për administrimin e ujit dhe rregullimin e territorit.

Duke patur parasysh numrin e madh të digave në vend dhe shqetësimet që lidhen me sigurinë e tyre, aktualisht qeveria shqiptare ka ndërmarrë një hap të parë drejt hartimit të një kuadri institucional dhe ligjor për sigurinë e digave.

Për administrimin e burimeve ujore në Shqipëri ka disa instrumente që janë në dispozicion: tarifa administrative për nxjerrjen e licencës për abstraksionin e ujit, tarifat e abstraksionit për ujrat sipërfaqërorë dhe nëntokësorë, tarifa për përdoruesit e ujit dhe ujitjes, tarifa për kanalizimet dhe gjoba në raste moszbatimi të rregullave. Tarifat e abstraksionit nuk praktikohen ende duke qenë se akoma nuk janë përcaktuar përqindjet aktuale.

Institucionet për administrimin e ujit

Në përputhje me ligjin e vitit 1996 për burimet ujore, u ngrit një njësi institucionale për administrimin e burimeve ujore. Në nivel qendror, Komiteti Kombëtar i Ujit, një ent vendim-marrës ku përfshihen të gjithë ministrat e sektorit të ujit, i kryesuar nga Kryeministri, me bashkëkryetar Ministrin e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacioneve; dhe Sekretariatit e tij Teknik pranë zyrës së Kryeministrit. Në nivel lokal, ligji kërkon krijimin e autoriteteve të baseneve të ujit.

Komiteti Kombëtar i Ujit ka marrë dy vendime të rëndësishme. I pari në lidhje me krijimin e një këshilli për basenet e ujit dhe një agjencie zbatimi për secilën nga gjashtë basenet, vendim që nuk u zbatua asnjëherë. Vendimi i dytë përcakton përgjegjësitë e këshillave të baseneve të ujit dhe agjencive të ujit në lidhje me nxjerrjen e lejeve të abstraksionit. Edhe ky vendim nuk u zbatua duke qenë se nuk ishin krijuar agjencitë e ujit. Pavarësisht nga përpjekjet e Komitetit Kombëtar të Ujit pak progress ka patur në lidhje me zbatimin e ligjit të vitit 1996. provë për këtë është progresi i kufizuar në futjen e një strategjie për ujin, mungesa e një inventari për burimet ujore dhe mos nxjerrja e asnjë autorizimi apo lejeje për përdorimin dhe shkarkimin e ujit. Mungojnë mekanizmat e zbatimit dhe ajo që është më e rëndësishme vendimet që merren për sektorin e ujit nuk mbështeten nga burimet e nevojshme financiare.

Probleme të ujrave ndërkufitare dhe ndërkombëtare

Duke qenë se afërsisht 35% e burimeve të rinovueshme të Shqipërisë vijnë nga vendet fqinje dhe rreth 50% e territorit është brenda baseneve ndërkombëtare të lumenjve, problemet ndërkufitare të ujit bëhen veçantisht shqetësuese për Shqipërinë.

Në vitin 1994, Shqipëria ratifikoi Konventën e UNECE-së për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Burimeve Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare dhe në vitin 2002 ratifikoi Protokollin për Ujin dhe Shëndetin. Shqipëria aktualisht po zbaton një sërë projektesh mjedisore në liqenet ndërkombëtare: Liqeni i Ohrit, bashkë me Maqedoninë, Liqeni i Prespës me Greqinë dhe Maqedoninë dhe Liqeni i Skadarit me Serbinë dhe Malin e Zi. Deri tani, nuk është përfunduar asnjë marrëveshje bilaterale me juridiksionet fqinje për trajtimin e problemeve të ujrave ndërkufitare. Me mbështetjen e Qendrës Rajonale të Mjedisit, po përgatitet një projekt i ri për lumin Drin, i quajtur “Master Plani për Ujëmbledhësin dhe Erozionin e Lumit Drin” që do të zbatohet nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Problemet dhe sfidat kryesore

Shqipërisë nuk i mungojnë burimet relativisht të shumta me ujë të freskët. Pas zhvillimit të gjithanshëm të burimeve ujore në rregjimin e kaluar, Shqipëria është e përgatitur mirë për zhvillim hidroenergjitik dhe ujitje. Gjatë dhjetë viteve të fundit ka patur një rënie drastike në tërheqjen e ujit për qëllime ujitjeje dhe industriale si rezultat i kolapsit të sektorit industrial. Rënia e aktivitetit ekonomik gjithashtu ka ulur ndotjen dhe ka përmirësuar cilësinë e burimeve ujore. Aktualisht vendi nuk rrezikon të kalojë një krizë uji, por zhvillimi i shpejtë i sektorit privat, procesi i urbanizimit, rehabilitimi i skemave ujitëse dhe planet për zgjerimin e kapacitetit hidroenergjitik mund të rrisin rastet e krizave lokale për ujë. Për të shmangur një krizë të tillë duhet që vendi fuqizojë kuadrin e vet aktual institucional për administrimin e burimeve ujore. Në këtë kontekst duhet mbajtur parasysh:

- Të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve ujore, duke përfshirë *ndër të tjera* një vlerësim të funksionimit aktual institucional, burimeve ujore dhe inventarit të kërkesës, bilancet rajonale të ujit dhe vlerësimi i problemeve që lidhen me cilësinë e ujit.

- Të bëhet rishikimi dhe azhurnimi i instrumenteve ligjore (amendamente në ligjin për Burimet Ujore dhe Mbrojtjen e Mjedisit, aprovimin e rregulloreve shtesë, etj.).
- Të ngrihen kapacitetet institucionale në mbështetje të njërive aq të nevojshme për administrimin e ujit, sidomos të atyre për licensimin e ekzekutimin, si edhe përgatitjen e planeve për basenet lumore.
- Të përmirësohet administrimi dhe të thellohet mbrojtja e burimeve ujore nëntokësore.
- Investimet afatshkurtra dhe afatgjata duhet të përqëndrohen në fushat e mëposhtme: sigurinë e digave, mbrojtjen nga përmbytjet, mbrojtjen dhe restaurimin e zonave të lagta dhe administrimin e ujëmbledhësive.

Referenca

Qeveria shqiptare. 2003. *Përgjigjija e Shqipërisë ndaj Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit*. Tiranë, Shqipëri. Raprotin mund ta gjeni në: <http://www.undp.org/mdg/countryreports.html>

Kombet e Bashkuara. 2003. *The OFDA/CRED International Disaster Database*. Department of Humanitarian Affairs and EM-DAT. Database available at: <http://www.cred.be/emdat/intro.html>





United Nations Economic Commission for Europe. 2002. *Environmental Performance Review of Shqipëria*. UNECE, Geneva, Switzerland.

World Bank. 1999. *Shqipëria Irrigation Development Project—Project Appraisal Document, Annex 2*. Washington, DC, USA.

World Bank. 2003. *Flood Profile for Shqipëria*. Prepared by Lucy Hancock from a report by Molnar Kolaneci for the World Bank, 2000. Washington, DC, USA.

ALBANIA: WATER FACT SHEET**SOCIO-ECONOMIC INDICATORS**

	1990	2000	2015	2020
Total Population (in million)	3.29	3.13	3.44	3.57
Urban population	36%	42%	52%	55%
Rural population	64%	58%	48%	45%
<i>Source: Aquastat database, FAO (2002).</i>				
	1998	2000	Goal for 2015	
Access to piped water supply	65%	67%	84%	
Urban	85%	90%	93%	
Rural	50%	50%	75%	
<i>Note: Goal refers to MDGs.</i>				
	1998	2000	Goal for 2020	
Access to sewerage	61%	59%	80%	
Urban	95%	90%	97%	
Rural	37%	37%	68%	
<i>Note: Goal refers to MDGs.</i>				
	1996			
Share of poor in rural areas	89%			
	1990	1995	1999	2000
GDP per capita (constant 1995 US\$)	841	769	863	914
GDP total (billions of 1995 US\$)	2.8	2.5	2.9	3.1
Share from agriculture	36%	55%	53%	55%
Share from industry	45%	22%	25%	26%
	1990	1991	1995	1999
Labor force (millions of people)	0.42	0.40	0.34	0.34
Share in agriculture	55%	24%		78%
Share in industry	23%	45%		
	1990-97	1998-00		
Average annual growth				
Of GDP	-1.4%	7.4%		
Of population	-0.4%	-0.1%		
	1999			
Infant mortality rate (per 1,000 live births)	24.3			
LAND AND WATER RESOURCES				
Land area (millions of ha)	2.88			
Land area in international basins (millions of ha)	1.43			
Percentage of country in international basins	49.6%			
Average precipitation (mm)	1,485			
Average total volume of rainfall (BCM)	1,485			
Total internal water resources (BCM)	26.9			
Of which surface water (BCM)	23.1			
Of which groundwater	6.2			
Overlap between surface and groundwater	2.4			
Total external water resources (BCM)	14.8			
Of which surface water (BCM)	14.8			
Of which groundwater (BCM)				
Total water resources (BCM)	41.7			
Of which total surface water (BCM)	37.9			
Of which total groundwater (BCM)	6.2			
Overlap between surface and groundwater	2.4			
Dependency ratio	35%			
	1990	2000	2015	2020
Per capita water resources (cubic meters/year)	12,679	13,306	12,126	11,697
	1987	1990	1995	
Total annual withdrawals (in BCM)	1.40	1.21	0.93	
Agricultural	0.99	1.00	0.67	
Domestic and industry	0.41	0.21	0.26	



WATER QUALITY AND POLLUTION

Wastewater produced	*			
Wastewater treated	*			
	1990	1993	1996	1997
Annual emissions of BOD per day (Tons)	34.8	12.5	5.8	6.5
Annual emissions of BOD per capita (kg)	3.86	1.40	0.67	0.76

AQUATIC ECOSYSTEMS

Wetlands designated as Ramsar sites (2002)	
In ha	20,000
As % of land area	0.70%

DAMS AND HYDROPOWER

Reservoir capacity (BCM)	4.56	(630 dams, and 306 >15 m)		
Irrigation dams	0.56			
Hydropower dams	5.04			
Reservoir capacity in cubic meters per capita	1,455			
Gross theoretical hydropower potential (GWh/y)	40,000			
Technically feasible (GWh/y)	15,000			
Economically feasible (GWh/y)	6,380			
Current production from hydropower (GWh/y)	5,283	(in 2000)		

	1990	1995	1998	1999
Total electricity production (M KWh)	3,198	4,414	5,068	5,396
Share from hydroelectric	89%	95%	97%	97%

IRRIGATION

	1990	1995	1998	1999
Irrigated land ('000 ha)	423	340	340	340
Irrigated land per capita (ha)	0.129	0.107	0.108	0.109
Irrigated land as share of cropland	60%	48%	49%	49%

FRESHWATER FISHERY

	1990	1995	1998	1999
Fishery production (metric tons)	6,836	734	1,102	1,302
Fishery production per capita (kg)	2.08	0.23	0.35	0.42

FINANCING THE WATER SECTOR

Average cost recovery:	2002	
Irrigation water services	40%	O&M costs
Municipal water services	30%-40%	O&M costs

* These are ball park estimates.

Average actual water price (US cent/m ³)	2001
Households	11-20
Industry	52-63
Irrigation	
Wastewater charges (US cent/m ³)	
Households	2.2-3.3
Industry	4.4-7.4

